

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 1, datë 15.2.2023

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E AVOKATËVE QË OFROJNË SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Në mbështetje të nenit 9, shkronja “a”, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kryetari i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas,

UDHËZOJNË:

1. Ky udhëzim ka për qëllim miratimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative, për çdo vit kalendarik.

2. Thirrja për shprehjen e interesit për listën e avokatëve të ndihmës juridike shpallet vit pas viti sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin e përbashkët ndërmjet ministrit të Drejtësisë dhe kryetarit të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nr. 17, datë 5.8.2020, “Për rregullat e zbatimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”.

3. Të drejtën për t’u bërë pjesë e listës për ofrimin e ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative e ka çdo avokat që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- b) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksioni publik për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent kur ka marrë formë të prerë;
- c) të mos ketë hequr dorë në mënyrë të njëanshme nga mbrojtja e subjekteve të parashikuara nga ligji nr. 111/2017, që kanë përfituar ndihmë juridike dytësore me vendim gjykatë, përveç rasteve të parashikuara në ligj;
- d) të mos ketë hequr dorë në mënyrë të njëanshme nga Kontrata e Shërbimit të lidhur me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, përveç rasteve të parashikuara në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe kontratës individuale të lidhur me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore;
- e) të marrë pjesë rregullisht në trajnimet që organizon Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

4. Në listën e hapur preferohen avokatë, të cilët kanë specializim/trajnimet e nevojshme për përfaqësimin e të miturve në konflikt me ligjin sipas Kodit të drejtësisë penale për të mitur, viktimave të dhunës në familje, të viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit.

5. Procedura e përzgjedhjes së avokatëve do të bëhet sipas kreut I, të udhëzimit të përbashkët nr. 17, datë 5.8.2020, “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”, të ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, dhomat vendore dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ergys Qirici

KRYETAR I DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË
Maksim Haxhia